



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 23 shtator 2024
Nr. Ref.: RK 2529/24

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI111/24

Parashtrues

Shpend Berisha

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit Rev. nr. 521/23, të 15 dhjetorit
2023, të Gjykatës Supreme të Kosovës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar,
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Shpend Berisha me vendbanim në Komunën e Vushtrrisë (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga Armend Krasniqi, avokat në Komunën e Prishtinës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit [Rev. nr. 521/23] të 15 dhjetorit 2023 të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktgjykimin [Ac. nr. 417/19] të 23 dhjetorit 2022 të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin mëtejme: Gjykata e Apelit) si dhe Aktgjykimin [C. nr. 3444/12] të 21 shtatorit 2018 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).
3. Parashtruesi i kërkesës aktvendimin e kontestuar e ka pranuar më 25 janar 2024.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkëlur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenet 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).
5. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që identiteti i tij të mos zbulohet, por pa dhënë ndonjë arsyetim lidhur me kërkesën e tij.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës nr. 01/2023 së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 10 maj 2024, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
8. Më 22 maj 2024, Kryetarja e Gjykatës përmes vendimit [nr. Gjr. KI111/24] caktoi gjyqtarin Jeton Bytyqi, gjyqtar raportues dhe përmes vendimit [nr. KSH. KI111/24] caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bajram Ljatifi (kryesues), Remzije Istrefi – Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
9. Më 29 maj 2024, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Në po të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të saj.
10. Më 29 maj 2024, Gjykata gjithashtu njoftoi Gjykatën Themelore për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ajo që të dorëzojë fletëkthesën që dëshmon se kur parashtruesi i kërkesës e kishte pranuar aktvendimin e kontestuar.
11. Më 31 maj 2024, Gjykata pranoi nga Gjykata Themelore fletëkthesën e kërkuar më 29 maj 2024.

12. Më 6 qershor 2024, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore që të dorëzojë fletëkthesën që dëshmon se kur parashtruesi i kërkesës e kishte pranuar Aktgjykimin [Ac. nr. 417/19] e 23 dhjetorit 2022 të Gjykatës së Apelit.
13. Më 13 qershor 2024, Gjykata pranoi nga Gjykata Themelore fletëkthesën e kërkuar më 6 qershor 2024.
14. Më 4 shtator 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

15. Më 27 tetor 2012, parashtruesi i kërkesës dhe personat M. B. dhe A. B., ishin përfshirë në një aksident komunikacioni që kishte ndodhur në rrugën rajonale Xërxë-Rahovec, me ç' rast këta të fundit kishin pësuar lëndime trupore. Aksidenti ishte shkaktuar nga një automjet i siguruar nga kompania e sigurimeve "Elsig" SH.A. (në tekstin e mëtejshëm: "Elsig").
16. Më 31 dhjetor 2012, parashtruesi i kërkesës dhe të dëmtuarit e tjerë paraqitën padi në Gjykatën Themelore ndaj "Elsig", duke kërkuar kompensimin e dëmit për shkak të lëndimeve të pësuar në aksidentin e lartcekur.
17. Më 7 shtator 2018, parashtruesi i kërkesës dhe të dëmtuarit tjerë, precizuan kërkesëpadinë, me ç' rast parashtruesi i kërkesës kërkoi shumën e përgjithshme prej shtatë mijë e njëqind euro (7,100.00) euro, në emër të kompensimit të dëmit material dhe jomaterial, shpenzimeve mjekësore si dhe shpenzimeve të tjera.
18. Më 21 shtator 2018, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C. nr. 3444/12], miratoi pjesërisht kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe të dëmtuarave tjerë, duke detyruar "Elsig" që t'i paguajë parashtruesit të kërkesës shumën prej katër mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë (4,675,00) euro, në emër të dëmit material dhe jomaterial, si dhe shpenzimeve procedurale.
19. Kundër Aktgjykimit të lartcekur, "Elsig" paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit, duke kontestuar shumën e kompensimit të përcaktuar nga Gjykata Themelore.
20. Më 23 dhjetor 2022, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [AC. nr. 417/19] aprovoi si pjesërisht të bazuar ankesën e "Elsig" duke ndryshuar pjesërisht aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës Themelore sa i përket dëmit material dhe jomaterial, përfshirë sa i përket parashtruesit të kërkesës dhe atë duke zbritur shumën e tërësishme për dëmin material dhe jomaterial për parashtruesin e kërkesës në dymijë e tetëqind (2,800.00) euro.
21. Më 17 janar 2023, avokati i parashtruesit të kërkesës e kishte pranuar Aktgjykimin e lartcekur [AC. nr. 417/19] të 23 dhjetorit 2022 të Gjykatës së Apelit.
22. Më 16 qershor 2023, kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës dhe të dëmtuarit tjerë, kishin dorëzuar në postë revizionin për Gjykatën Supreme, të cilën kjo e fundit e kishte pranuar më 26 qershor 2023, duke pretenduar zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike me propozim që të ndryshohen aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta përkitazi me shumën dhe kompensimin të dëmit. "Elsig" kishte paraqitur përgjigje në revizion, duke kërkuar që e njëjta të refuzohet si e pa themeltë.
23. Më 15 dhjetor 2023, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [Rev. nr. 521/23] hodhi si të paafatshëm revizionin e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës dhe të dëmtuarit

tjerë, duke arsyetuar se Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit ishte pranuar nga avokati i parashtruesit të kërkesës më 17 janar 2023, përderisa revizioni ishte dorëzuar në postë më 16 qershor 2023 dhe ishte pranuar nga Gjykata Supreme më 26 qershor 2023. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme konstatoi se kishte kaluar afati tridhjetë (30) ditor për paraqitjen e revizionit i përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 221 (pa titull) të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në tekstin e mëtejshëm: LPK).

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Parashtruesi i kërkesës pretendon para Gjykatës se Aktvendimi [Rev. nr. 521/2023] i 15 dhjetorit 2023 i Gjykatës Supreme është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara përmes neneve 31 dhe 32 të Kushtetutës, dhe neneve 6 dhe 13 të KEDNj-së.
25. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme ka llogaritur gabimisht afatin për paraqitjen e revizionit kundër Aktgjykimit [Ac. nr. 417/19] të Gjykatës së Apelit. Kjo pasi, sipas tij, Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit fillimisht u dorëzua gabimisht tek një avokat tjetër [...] në vend që t'i dërgohej Av. Armend Krasniqi, i është dërguar Av. [N.M], i cili [...], pas kalimit të një periudhe kohore, me parashtrësë e ka informuar Gjykatën Themelore [...] se gabimisht e ka pranuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore [...] C. nr. 3444/12, dhe të njëjtin ia ka kthyer Gjykatës [Themelore], që t'ua dërgojë palës dhe avokatit”.
26. Sipas tij, “Gjykata Supreme as që nuk është marrë me shiqimin e faktit se kush dhe kur e kishte pranuar Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Prishtinës, Ae. m. 417119, të datës 23.12.2022, dhe fare nuk e kishte shiquar as parashtrësën e avokatit [N.M]”, duke shkelur kështu, sipas tij, edhe nenin 32 të Kushtetutës sipas të cilit çdo person ka të drejtë të përdorë mjete juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative që cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij, në mënyrë e përcaktuar me ligjin.
27. Andaj, parashtruesi i kërkesës kërkon që “[...] kërkesën e paraqitur ta konsideroni si të pranueshme dhe të bazuar në ligj, ngase asnjëra prej Gjykatave nuk u bazua në dokumentacion/provat, ekspertizat mjeko-ligjore të cilat kanë konstatuar lëndimet trupore të cilat i kanë pësuar paditësit si pasojë e aksidentit të komunikacionit rrugorë të 27.10.2012, e të cilat gjinden në shkresat e lëndës prej të cilave do të vërtetohej se paditësit janë dëmtuar skajshmërisht, me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit [...], e që kjo gjykatë, nuk kishte nxjerrur asnjë ekspertizë mjeko-ligjore/provë tjetër, për ta bazuar uljen e shumave të gjykuara, e të cilën ulje e ka zbritur rreth 50%”.

Dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
 2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
- [...]

Neni 32

[E Drejta për Mjete Juridike]

Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6 (E drejta për një proces të rregullt)

*1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohej drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.
[...]*

Neni 13 (E drejta për zgjidhje efektive)

“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare”.

Ligji nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore

Revizioni Neni 211

*211.1 Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, palët mund të paraqesin revizion brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën u është dorëzuar aktgjykimi.
[...]*

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

28. Gjykata së pari vlerëson nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]*

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

29. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç parashihen më tutje në Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individit mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë".

Neni 49
(Afatet)

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]".

30. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata fillimisht thekson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, që konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [Rev. nr. 521/23] e 15 dhjetorit 2023 Gjykatës Supreme, dhe kërkesën e ka parashtruar brenda afatit pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Gjithashtu, parashtruesi i kërkesës i ka qartësuar të drejtat dhe liritë kushtetuese, që ai pretendon se i janë shkelur.
31. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 34 (Kriteret e pranueshmërisë), përkatësisht me paragrafin (2), të rregullit 34 të Rregullores së punës, që përcakton:

"Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, kur parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj".

32. Gjykata fillimisht thekson se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GjEDNj) dhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës. Bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si "qartazi e pabazuar" në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime "të shkallës së katërt"; (ii) pretendime që

- kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkëljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih, rastet e GjEDNj-së [Kemmachev kundër Francës](#), nr. 17621/91, Aktgjykim i 24 nëntorit 1994, paragrafi 44 [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), nr. 4241/03, vendimi i 31 majit 2005, paragrafi 55; [Mentzen kundër Letonia](#), Kërkesa nr. 71074/01, [Baillard kundër Francës](#), nr. 6032/04, vendimi i 25 shtatorit 2008, dhe rastet e Gjykatës [KIO4/21](#), parashtruese [Nexhmije Makolli](#), Aktvendim për papranueshmëri, i 13 prillit 2021, paragrafi 26; [KI107/21](#), parashtrues [Ramiz Hoti](#), Aktvendim për papranueshmëri, i 21 tetorit 2021, paragrafi 53; dhe [KIO5/23](#), parashtrues [Branislav Gajin](#), Aktvendim për papranueshmëri, i 17 janarit 2024, paragrafi 51).
33. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
34. Bazuar në dosjen e rastit, rezulton se parashtruesi i kërkesës dhe disa persona të tjerë me automjetin e tyre ishin përfshirë në një aksident komunikacioni të shkaktuar nga një automjet i siguruar tek “Elsig” me ç’ rast të njëjtit kishin pësuar lëndime trupore. Si pasojë parashtruesi i kërkesës dhe personat e tjerë kishin paraqitur padi në Gjykatën Themelore ndaj “Elsig”, duke kërkuar kompensimin e dëmit të pësuar si pasojë e aksidentit. Gjykata Themelore miratoi pjesërisht kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe të dëmtuarave tjerë, duke detyruar “Elsig” që t’i paguajë parashtruesit të kërkesës shumën prej katër mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë (4,675,00) euro, në emër të dëmit material dhe jomaterial, si dhe shpenzimeve procedurale. Megjithatë, duke vepruar sipas ankesës së “Elsig”, Gjykata e Apelit kishte zvogëluar shumën e akorduar nga Gjykata Themelore për parashtruesin e kërkesës në dymijë e tetëqind (2,800.00) euro. Më 17 janar 2023, avokati i parashtruesit të kërkesës e kishte pranuar Aktgjykimin e lartcekur [AC. nr. 417/19] të 23 dhjetorit 2022 të Gjykatës së Apelit. Më 16 qershor 2023, kundër aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës dhe të dëmtuarit tjerë, kishin dorëzuar në postë revizionin për Gjykatën Supreme, të cilën kjo e fundit e kishte pranuar më 26 qershor 2023. Më 15 dhjetor 2023, Gjykata Supreme hodhi poshtë si të paafatshëm revizionin e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës dhe të dëmtuarit tjerë, pasi sipas Gjykatës Supreme Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit ishte pranuar nga avokati i parashtruesit të kërkesës më 17 janar 2023, përderisa revizioni ishte dorëzuar në postë më 16 qershor 2023 dhe ishte pranuar nga Gjykata Supreme më 26 qershor 2023. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme konstatoi se në rastin konkret, kishte kaluar afati tridhjetë (30) ditor për paraqitjen e revizionit.
35. Parashtruesi i kërkesës përkitazi me Aktvendimin e kontestuar pretendon se Gjykata Supreme ka llogaritur gabimisht afatin për paraqitjen e revizionit kundër Aktgjykimit [Ac. nr. 417/19] të Gjykatës së Apelit. Kjo pasi, sipas tij, Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit fillimisht u dorëzua gabimisht tek një avokat tjetër në vend që t’i dërgohej avokatit Armend Krasniqi, përkatësisht avokatit N. M. i cili pastaj të njëjtin ia kishte kthyer Gjykatës Themelore. Andaj, ai pretendon se Gjykata Supreme, duke vendosur që revizioni është paraqitur jashtë afatit, ka cenuar të drejtën e tij për të përdorur mjete juridike ndaj Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, në kundërshtim me nenet 31 dhe 32 të Kushtetutës dhe nenet 6 dhe 13 të KEDNj-së, dhe si pasojë nuk ishin trajtuar pretendimet e tij sa i përket provave dhe ekspertizave të cilat kanë konstatuar lëndimet trupore të tij dhe gjetjeve të Gjykatës së Apelit.

36. Gjykata rithekson se neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike] i Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 13 të KEDNj-së garanton të drejtën për të përdorur mjet juridik kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat e garantuara në mënyrën e përcaktuar me ligj; (ii) të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë është shkelur; dhe (iii) të drejtën për një zgjidhje efektive nëse është shkelur një e drejtë e garantuar me Kushtetutë dhe KEDNj, respektivisht (shih, në mënyrë analoge, rastin e GjEDNj-së, [Boyle dhe Rice kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 9659/82; 9658/82, Aktgjykim i 27 prillit 1998, paragrafi 52; dhe rastin e Gjykatës [KI48/18](#), parashtrues: *Arban Abrashi dhe Lidhja Demokratike e Kosovës*, Aktgjykim i 23 janarit 2019, paragrafi). Gjykata më tej thekson se kjo e drejtë nuk është absolute, por mund t'i nënshtrohet kufizimeve, pasi që nga vetë natyra e saj kërkon rregullim nga shteti, i cili gëzon një liri të caktuar vlerësimi në këtë drejtim.
37. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se Gjykata Supreme e kishte hedhur poshtë revizionin e parashtruesit të kërkesës për arsye procedurale, përkatësisht pasi i njëjti ishte paraqitur jashtë afatit tridhjetë (30) ditor të përcaktuar me ligj. Kjo pasi aktgjykimi i Gjykatës së Apelit ishte pranuar nga avokati i parashtruesit të kërkesës më 17 janar 2023, përderisa revizioni ishte dorëzuar në postë më 16 qershor 2023. Lidhur me këtë, edhe Gjykata ka kërkuar fletëkthesën nga Gjykata Themelore sipas së cilës rezultoi se avokati i parashtruesit të kërkesës, Armend Krasniqi, e kishte pranuar aktgjykimin e Gjykatës së Apelit më 17 janar 2023.
38. Në këtë kontekst, Gjykata i referohet paragrafit 1 të nenit 211 të LPK-së që përcakton se palët mund të paraqesin revizion brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën u është dorëzuar aktgjykimi i shkallës së dytë. Prandaj, rezultoi se pavarësisht nëse Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit i ishte dorëzuar gabimisht avokatit N. M., rezultoi se në fakt avokati i parashtruesit të kërkesës Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit e kishte pranuar dhe atë më 17 janar 2023, dhe nga kjo datë deri më 16 qershor 2023, kur revizioni për Gjykatën Supreme ishte dorëzuar përmes postës, kishin kaluar më tepër se tridhjetë (30) ditë, sa ishte edhe afati për të paraqitur revizionin në Gjykatën Supreme. Andaj, bazuar në të lartcekurat rezultoi se procedurat para Gjykatës Supreme ishin zhvilluar bazuar në kërkesat procedurale për të shqyrtuar revizionin, përkatësisht afatet procedurale të përcaktuara në LPK.
39. Në këtë aspekt, GjEDNj ka theksuar se rregullat që përcaktojnë hapat procedural që kërkohet të ndërmerren dhe afatet kohore të cilat duhet të respektohen sa i përket paraqitjes së ankesës janë krijuar për të siguruar administrimin e duhur të drejtësisë dhe pajtueshmërinë, veçanërisht, me parimin e sigurisë juridike (shih rastin e GjEDNj [Ben Salah Adraqui and Dhaimë kundër Spanjës](#), nr. 45023/98, Vendim i 27 prillit 2000).
40. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të neneve 31 dhe 32 të Kushtetutës dhe neneve 6 dhe 13 të KEDNj-së si pasojë që Gjykata Supreme ka gjetur se revizioni ndaj aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, është paraqitur jashtë afatit ligjor, janë pretendime që kategorizohen me një “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*”, dhe rrjedhimisht, të papranueshme si qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, ashtu siç është përcaktuar me nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 34 (2) të Rregullores së punës.

Kërkesa për moszbulim të identitetit

60. Lidhur me kërkesën për moszbulim të identitetit, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka kërkuar mbrojtjen e identitetit por nuk arsyeton kërkesën e tij.
41. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet paragrafit 1 të rregullit 24 të Rregullores së punës, i cili përcakton:

"(1) Kurdo përgjatë procedurës së shqyrtimit të një kërkesë individuale sipas paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe deri në publikimin e vendimit përfundimtar, palët mund të kërkojnë që identiteti i tyre të mos zbulohet publikisht. Kërkesa duhet të jetë e arsyetuar".

42. Duke marrë parasysh rrethanat e rastit konkret përfshirë faktin që parashtruesi i kërkesës nuk e ka arsyetuar kërkesën për moszbulim të identitetit, bazuar në paragrafin 1 të rregullit 24 të Rregullores së punës, Gjykata e refuzon kërkesën e parashtruesit të kërkesës për moszbulimin e identitetit të tij publikisht.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20, 47 dhe 48 të Ligjit dhe me rregullat 24, 34 (2) dhe 48 (1) (b) të Rregullores së punës, më 4 shtator 2024, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TË REFUZOJË kërkesën për moszbulim të identitetit;
- III. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- IV. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit, në Gazetën Zyrtare;
- V. TË KONSTATOJË që ky Aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues

Jeton Bytyqi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani